



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr- 016-3807

Me date 20.01.2026

Në bazë të nenit 13 dhe 58, të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008", nenit 30 dhe 45 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, e ne mbështetje të nenit 10 të Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të Komunës, 01-Nr-016-20161 të datës 30.03.2021 Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit

1. Formohet komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave që parashtrohen nga personat fizik dhe juridik, për marrjen e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim për periudhën me pak se një (1) vit për Drejtorin për shërbime publike dhe emergjencë në këtë përbërje;

- 1.1 Florinda ISUFaj -----kryesuese
- 1.2 Sami VATAJ--- -----anëtar
- 1.3 Agron BAJRAKTARI -----anëtar

2. Detyrë dhe përgjegjësi e komisionit është që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave që parashtrohen nga personat fizik dhe juridik, për marrjen e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim për periudhën me pak se një (1) vit, se a i përmbushin kushtet dhe kriteret konform Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të Komunës, 01-Nr-016-20161 të datës 30.03.2021 dhe t'i rekomandojnë Drejtorit të Drejtorisë përkatëse për nënshkrimin e kontratës.

3. Mandati i anëtareve të komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave është dy (2) vite.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.



Kryetari i Komunës

Bali MUHARREMAJ

Te njoftohet:

Drejtoria e shërbimeve publike

Komisioni

Arkiva